

## Abstrakt i punimit

### Kushtetutshmëria e masave kundër Covid 19 në Kosovë

Adonita Karavidaj

Master i Shkencave Juridike

Fakulteti Juridik - Drejtimi Kushtetues Administrativ, Prishtinë, 2023

Studimi mbi kushtetushmërinë e masave të marra gjatë pandemisë COVID-19 është një çështje komplekse dhe mund të vlerësohet ndryshe nga individët dhe institucionet e ndryshme.

Kushtetutshmëria e tyre varet nga konteksti ligjor dhe institucional i secilit vend, si dhe nga vlerësimi i kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore në përputhje me emergjencën e shëndetit publik. Andaj edhe studimi i kësaj teme është e një rëndësie të veçantë, e që në këtë punim do të gjeni materiale, papajtueshmëri, komentime, studim analitik si dhe përfundime interesante.

Ky punim ka për qëllim të analizojë kushtetutshmërinë e masave kundër Covid-19 në Kosovë dhe të shqyrtojë nëse ato i plotësojnë standardet juridike dhe të drejtat individuale. Përmes një hulumtimi kuantitativ do të analizohet perceptimi nga anëtarët e Policisë dhe Inspektoratit Sanitar të Kosovës mbi atë se nëse këto masa respektojnë të drejtat e individëve dhe nëse janë zbatuar në përputhje me ligjin dhe kushtetutën.

Hulumtimi do të jetë i përqendruar te legjislacioni dhe vendimet e marra nga Qeveria e Kosovës dhe perceptimi i anëtarëve të Policisë dhe Inspektoratit Sanitar të Kosovës në Komunën e Prizrenit. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorë metoda e anketimit përmes pyetësorëve. Pyetjet janë kryesisht sasiore dhe ato janë të tipit me shumë përgjigje dhe të llojit Likert. Pyetësi është përdorur për të anketuar pjesëmarrës të Policisë dhe Inspektoratit Sanitar të Kosovës.

Punimi përmban gjithsej 5 kapitujt, ku përvec hyrjes standarde më tre kapitujt e parë përmbajnë kërkimin doktrinar, analizën e legjislacionit dhe metodën deskriptive. Më pas, në kapitullin e katërt jam fokusuar te pjesa analitike e studimit, ku ky kapitull përmban analizën e të dhënave

dhe përmes instrumenteve, pershkrimin dhe komentimin e të dhënave për të kaluar pastaj tek kapitulli i fundit i cili jep përfundimet dhe rekomandimet.

Fjalët kyçe: kushtetushmëria, ligji, masat ndaluese, pandemia Covid 19, të drejtat e njeriut